



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS VITI

Numri i lëndës: 2019:084423

Datë: 15.11.2024

Numri i dokumentit: 06457231

**P.nr.171/2019**

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN- DEGA NË VITI, Departamenti i përgjithshëm**, në përbërje nga gjyqtarja e vetme gjykuese Blerina Jakupi Ramadani, me bashkëpunëtorin profesional Fitim Limani në çështjen penale ndaj të akuzuarit A.I. nga fshati G., Komuna Viti, për shkak të veprës penale shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm nga neni 365 paragrafi 6, lidhur me paragrafin 1 të Kodit Penal të Kosovës, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr.494/2019, e datës 28.03.2019, pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit gjyqësor dhe publik, të datës 05.11.2024, me datë 08.11.2024, në mungesë të palëve mori dhe shpalli, kurse me datë 15.11.2024, përpiloi me shkrim këtë:

**A K T G J Y K I M**

**I akuzuari A.I.**, nga babai Z., nëna H., e lindur A., i lindur me datë 09.02.1995, në fshatin G. Komuna Viti, me vendbanim në të njëjtin vend, i pa martuar, ka të kryer shkollën fillore, i gjendjes së varfër ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me numër personal 1243137027.

**Në bazë të nenit 363 paragrafi 1, nën paragrafi 1.3 i KPPR-së:**

**LIROHET NGA AKUZA**

Sepse, me datën 21.02.2019, rreth orës 16:30, në fshatin G., Komuna e Vitisë, i akuzuari A.I., nga pakujdesia ka shkaktuar rrezik të përgjithshëm për jetën e njerëzve dhe pasurinë e tyre, në atë mënyrë që i akuzuari duke shkuar tek arat e veta për të lëvruar dhe gjatë rrugëtimit deri tek arat e veta, ndalet tek kanali rreth rrugës dhe me qëllim të pastrimit të kanalit nga mbeturinat, të njëjtat mbeturina i ndezë dhe më pastaj nuk kujdeset për zjarrin që ta fik, ndërsa zjarri pastaj kalon dhe përfshinë pronën djerrinë të pronarit Q.H., pastaj kalon dhe përfshinë pronën e E. Hajdari, duke djegur dhe asgjësuar barin e thatë dhe 20 fidanë të mbjella, ndërsa më vonë për ta lokalizuar zjarrin kanë intervenuar njësia e zjarrfikësve nga Vitia, në këtë mënyrë i akuzuari me veprimet e veta nga pakujdesia ka shkaktuar rrezik të përgjithshëm për jetën e njerëzve dhe pasurinë e tyre dhe njëkohësisht si pasojë e zjarrit të dëmtuarit të sipër cekur i është shkaktuar edhe dëm material në vlerë prej rreth 500 euro.

-me këtë kishte për të kryer veprën penale shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm nga neni 365 paragrafi 6, lidhur me paragrafin 1 i KPRK-së.

I dëmtuari E. (Ramadan) Kamberi, nga Prishtina, lagjja Arbëria I, rruga "Ismail Qemajli", për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

Konform nenit 453 paragrafi 1 të KPRK, shpenzimet e procedurës penale bien në llogari të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate.

**A r s y e t i m**

### **1.Rrjedha e çështjes dhe fjalët përfundimtare të palëve**

Prokuroria Themelore në Gjiilan-Departamenti i Përgjithshëm me datë 28.03.2019, ka paraqitur në gjykatë aktakuzën PP.II.nr.494/2019, të datës 228.03.2019, ndaj të akuzuarit A.I.nga fshati G., Komuna Viti, për shkak të veprës penale shkaktim i rrezikut të përgjithshëm nga neni 365 paragrafi 6, lidhur me paragrafin 1 të Kodit Penal të Kosovës.

Gjykata me datë 23.03.2022, ka mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar dhe publik, në të cilën ishin prezent prokurorja e shtetit Leonora Kadriu dhe i akuzuari A.I.. Në këtë seancë i akuzuari A.I., pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurores së shtetit ka deklaruar se e ka kuptuar në tërësi aktakuzën dhe veprën penale për të cilën akuzohet dhe nuk e pranon fajësinë për kryerjen e saj, me ç'rast gjykata në kuptim të nenit 245 paragrafi 5 dhe 6, si dhe neneve 249 dhe 250 të KPPRK-së, e ka njoftuar të akuzuarin se mund të paraqes propozimet për provat e cekura në aktakuzë dhe kundërshtim të provave, mirëpo i njëjtit nuk e ka shfrytëzuar këtë të drejtë.

Në seancën e shqyrtimit gjyqësor dhe publik të datës 03.10.2024, ishin prezent prokurori i shtetit Adnan Hajdari, i dëmtuari E.K. dhe i akuzuari A.I.. Në këtë seancë është dëgjuar i dëmtuari, në cilësi të dëshmitarit E.K., janë dëgjuar dëshmitarët Mehmet Mehmeti, ndërsa në seancën e shqyrtimit gjyqësor dhe publik të datës 05.11.2024, ishin prezent prokurorja e shtetit Kujtesa Fazliu dhe i akuzuari A.I.. Në këtë seancë është dëgjuar dëshmitari M.D., janë administruar provat, është marrë në pyetje i akuzuari, si dhe është dhënë fjala përfundimtare e palëve. I dëmtuari është ftuar në mënyrë të rregullt, mosardhjen nuk e ka arsyetuar.

Prokurorja e shtetit Kujtesa Fazliu, në fjalën përfundimtare ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë aktakuzës dhe propozimeve që e njëjta i përmban. Ka theksuar se gjendja faktike në këtë çështje penale juridike është vërtetuar si nga deklarata e të dëmtuarit E.K., si dhe dëshmitarët- zyrtarët policor M.D. dhe Mehmet Mehmeti, si dhe nga provat materiale si në shkrE. e lëndës, po ashtu edhe ato të shqyrtuar gjatë seancave gjyqësore. Se është kryer vepra penale, me dëshminë e tij e ka vërtetuar edhe i dëmtuari E.K., i cili në këtë gjykatë ka deklaruar se lidhur me zjarrin e ndodhur në pronën e tij, informatën e ka marrë nga djali i vëllait të tij G.K., pastaj i ka shikuar kamerat dhe nga ky zjarr ka pësuar edhe dëme në pronën e tij. Ka theksuar se edhe zyrtarët policor M.D.dhe M.D., me dëshminë e tyre kanë vërtetuar veprën penale, ku ndër të tjera M.D. deklaroj se ka pranuar një informatë anonime se personi i dyshuar që ka ndezur disa mbeturina në kanal është pikërisht tani i akuzuari A.I.. Vepra penale është vërtetuar edhe nga deklarata e të akuzuarit e dhënë në polici, i cili ka deklaruar se duke kaluar afër kanalit-afër arës së tij, i ka ndezur disa mbeturina në kanal, të cilën deklaratë e mohoj në shqyrtimin gjyqësor, mirëpo deklarata e dhënë në polici, e cila është dhënë pas kryerjes së veprës penale, përveç se me dëgjimin e palëve, vepra penale është vërtetuar edhe me provat materiale, duke theksuar se në veprimet e tani të akuzuarit janë të përmbajtura të gjitha elementet e veprës penale, shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm ashtu siç është përshkruar në aktakuzë. Duke kërkuar nga gjykata që të njëjtin ta shpall fajtor dhe ta dënoj me dënim të paraparë me ligj, duke i marrë parasysh të gjitha rrethanat, si ato lehtësuese po ashtu edhe ato rënduese. I akuzuari A.I.në fjalën e tij përfundimtare ka kërkuar nga gjykata që të lirohet nga përgjegjësia penale, duke theksuar se nuk e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet dhe se nuk e ndien veten fajtor.

### **2. Provat e administruara personale dhe materiale gjatë shqyrtimit gjyqësor**

Pas prezantimit të provave, gjykata plotësisht ka vërtetuar gjendjen faktike si në dispozitiv të aktgjykimit dhe atë:

- Raporti fillestar i incidentit me numër të rastit 2019-CG-067, i datës 21.02.2019, paraqitur nga Njësia e hetimeve të Stacionit Policor në Viti,
- Deklarata e të dëmtuarit E.K. e dhënë me datën 21.02.2019, e dhënë në Stacionin Policor në Viti,
- Deklarata e të akuzuarit A.I.e dhënë me datën 14.03.2019, e dhënë në Stacionin Policor në Viti,
- Raport zjarri me numër Pr. 14/2019, e dates 23.02.2019, e lëshuar nga Ministria e Punëve të Brendshme, Zyra e Preventives ndaj zjarrit-Viti, si dhe
- Një fotografi nga vendi i ngjarjes.

#### **2.1. Deklarata e të dëmtuarit E.K.**

I dëmtuari E.K.,i dëgjuar në cilësi të dëshmitarit, në seancën gjyqësore të datës 03.10.2024 deklaroi: në fidanishten e tij, e cila gjendet në fshatin G. Komuna Viti, në sipërfaqe të tërësishme rreth një hektar e gjysëm, ka të vendosura 8 kamera të sigurisë, të cilat e përcjellin të gjithë sipërfaqen e kësaj parcele. Nuk i është kujtuar data e saktë, mirëpo ka theksuar se ditën kritike përmes kamerave ka parë një kerr

(rimorkio), ku kishte të vendosur pleh. Kjo rimorkio ishte e vendosur në arën e babait të A.I.t dhe në bazë të kamerave, kishte parë dy persona të cilët nuk ka mundur ti identifikoj, e të cilët ishin duke e zbrazur plehun nga rimorkio në tokën e tyre. Ka theksuar se ara-prona e tij, e cila i është dëmtuar, nuk është e kufizuar me arën e A.I.t, gjegjësisht prindit të tij, ndërsa prona e prindit të A.I.t kufizohet me pronën e Q.H.t, ku edhe prona e Q.H.t kufizohet me pronën e të dëmtuarit. Nuk e kishte parë momentin kur është ndezur zjarri, por e kishte parë momentin kur zjarri ka përfshirë sernishten në arën e Qahili Hajdarit, ndërsa kur e ka parë që zjarri është afuar te prona e tij (tek dardhat), e ka thirrë policinë dhe zjarrfikësit. Në atë kohë jetonte në Prishtinë, ku edhe kamerat i vëzhgonte nga atje dhe ditën kritike, pasdite ka dalur në vendin e ngjarjes dhe aty ka takuar zjarrfikësit duke fikur zjarrin, mirëpo nuk e ka ditur nëse policia a kanë dalur atë ditë apo ditën e nesërme në vendin e ngjarjes, ndërsa një zyrtari policor të cilit nuk ja ka ditur emrin i ka thënë ti marrin inçizimet e kamerave, mirëpo i njëjti i kishte thënë se kjo është procedurë e veçantë.

Të akuzuarin dhe babain e tij i njeh pasiqë me të njëjtit kanë jetuar në të njëjtin fshat. Me rastin e ballafaqimit me deklaratën e dhënë në Stacion Policor në Viti, me datën 21.02.2019, ku i njëjti kishte deklaruar “informatën e kam marrë nga familjarët e mi që jetojnë në fshat”, ndërsa në seancë deklaroi se “përmes kamerave e kishte vërejtur zjarrin”. I dëmtuari deklaroi se e vërteta është se ditën kritike informatën e rreth zjarrit e ka marrë nga një familjar i A.I.t, emrin e të cilit fillimisht theksoj se nuk dëshiron ta tregoj, ndërsa më vonë ndryshoi deklaratën duke thënë se informatën për zjarrin e kishte marr nga djali i vëllait të tij i cili quhet G.K., pastaj i dëmtuari i kishte shiquar kamerate sigurisë. Asnjë person nuk i kishte thënë se A. e ka ndezur zjarrin, por kjo është vërtetuar nga zyrtarët policor. Pjesa e pronës që i është dëmtuar nga zjarri kanë qenë të vendosur 270 trupa fidanë të llojit dardhë dhe se të gjitha i janë dëmtuar së bashku me sistemimin e ujitjes.

## **2.2. Deklarata e dëshmitarit Mehmet Mehmeti**

Dëshmitari Mehmet Mehmeti, në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 03.10.2024, deklaroi se ishte zyrtari i parë të cilit i ishte raportuar ky rast. Nuk i është kujtuar se me cilin koleg kanë shkuar ta vizitojnë vendin e ngjarjes ku ishte i pranishëm tani i dëmtuari i cili ka qenë prezent në seancë. Ka theksuar se aty kanë vërejtur se ishte një plantacion i madh dhe ka vërejtur se në anën e djathtë të kësaj prone ka qenë një sernishte e djegur, kurse në pronën e të dëmtuarit ka theksuar se 3-4 rende të trupave mollë dhe dardhë (nuk e dinte numrin e saktë të trupave), por e dinte se këta trupa kanë qenë të dëmtuara nga temperatura e sernishtes. Në vendin e ngjarjes nuk ka vërejtur zjarr aktiv, pasiqë atje kishte shkuar pas 2-3 ore. Kishte intervistuar të dëmtuarin në vendin e ngjarjes dhe kishin bërë fotografi, mirëpo nuk ka pasur njohuri se kush e ka përmendur tani të akuzuarin si kryes i kësaj veprë penale, ndërsa me zjarrfikësit nuk është takuar, as me persona tjerë përveç të dëmtuarin dhe nuk kishte njohuri se prej kujt i dëmtuari është njoftuar për zjarrin.

## **2.3. Deklarata e dëshmitarit M.D.**

Dëshmitari M.D., në dëshminë e dhënë në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 05.11.2024, ka deklaruar se ishte hartues i kallëzimit penal në këtë çështje. Nuk i kujtohej me cilët kolegë ka qenë por e dinte se tri ose katër ditë pas lajmërimit të rastit, kanë dalur në vendin e ngjarjes në fshatin G. Komuna Viti, ku është një kanal i hapur në pronë publike, në të cilin fshatarët e këtij vendi hedhin mbeturina. Ka theksuar se në pronën publike është ndezur një zjarr me qëllim që të ndizen mbeturinat, mirëpo zjarri ishte shpërndarë edhe në pronat përrreth. Prona e E.K.t ishte dëmtuar nga zjarri, ku kishte të mbjellura fidane dardhë, të cilat fidanë nuk kanë qenë të mirëmbajtura mirë nga pronari E.K., ku në mes tyre kishte dalur bari i thatë, i përshtatshëm për tu ndezur. Ishte një dëshmitar anonim nga i njëjti fshat, të cilin e kishin takuar kur kanë dalur në terren në fshatin G., i cili në mënyrë verbale, i ka njoftuar se e ka parë A.I.n, i ka treguar edhe datën, duke i ndezur mbeturinat dhe se sipas këtij dëshmitari (anonim), A. ishte duke lëvruar arën e vet, ndërsa ka dalur në pronën publike, ku ishin të vendosur këto mbeturina, e kishte ndezur një cigare dhe e kishte hedhur te mbeturinat dhe nga ky veprim i A.t, pasi që është ndezur zjarri dhe se dëshmitari anonim kishte qenë kalimtar i rastit mirëpo nuk e ka shënuar këtë datë në kallëzim penal, mirëpo ky dëshmitar (anonim) për t'i ikur konfliktit (me tani të akuzuarin) nuk e ka treguar identitetin e tij.

Rasti në Stacionin Policor në Viti nga i dëmtuari është raportuar një ditë më vonë, mirëpo nuk i kujtohej saktësisht se pas dy apo tri dite të raportimit të rastit kanë dalur në vendin e ngjarjes. Në vendin ku është ndezur zjarri, shtëpitë janë të vendosura rreth 300 metra larg dhe nga zjarri nuk ka pasur rrezik për këto shtëpi, si dhe zjarri nuk ka paraqitur rrezik për njerëzit. Distanca në mes pronës së E.K., ku ishin të vendosura fidanet dhe vendit ku është ndezur zjarri ishte në largësi rreth 50 metra, e cila nuk kufizohej

me pronën shtetërore ku është ndezur zjarri (mbeturinat), pasi që me pronën shtetërore kufizohej një pronë tjetër e cila ishte dëmtuar nga ky zjarr dhe nga kjo pronë zjarri ka depërtuar në pronën e E.K.t. E.K. në fshatin G. Komuna Viti, ka dy prona ku kishte të vendosura fidanë, një pronë ishte në anën e majtë të kanalit ku ishin ndezur mbeturinat, ku E.K. ka të mbjella fidanë dhe ka një shtëpi verore, ku këtë pjesë nuk e ka kapluar zjarri. Ndërsa pronën e cila gjendet në anën e djathtë të kanalit ku janë ndezur mbeturinat E.K. ka të mbjella fidanë dardhë, sasia nuk i kujtohej, këtë pjesë e ka kapluar zjarri dhe i ka dëmtuar fidanet dhe një sistem të ujitjes. Në shtëpinë e E.K.t kishte të vendosura kamera të sigurisë mirëpo nuk e dinte nëse ndonjë kamerë e sigurisë ka regjistruar pamjen e pjesës së pronës së E. ku është kapluar nga zjarri. E kishte pyetur E.n për këto kamera, pasi që kanë pasur qëllim që të verifikojnë, mirëpo i dëmtuari u kishte thënë “se kamerat nuk i kanë regjistruar pamjet për shkak të hardiskut me memorie të vogël, pasi që kamerat i regjistrojnë ngjarjet e ndodhura vetëm 2-3 ditë. Nuk e kishte intervistuar E.K.n në Stacionin e Policisë në Viti por i është kujtuar se gjatë verifikimit të kamerave në telefonin e E., i kishte thënë se A.n, ditën kritike përmes kamerave të sigurisë e kishte parë duke ndezur zjarrin, ndërsa person tjetër nuk ka përmendur. A. gjatë deklaratës së dhënë në Stacion Policor në Viti e kishte pranuar se ka ndezur disa mbeturina në këtë kanal, ku edhe kishte ndezur një cigare dhe se në ditën kritike ishte duke lëvruar pronën e tij dhe ka deklaruar se nuk ka qenë e mundur nga zjarri që ka ndezur ai, të jetë përhapur zjarri edhe në prona tjera. A.I.nuk kishte ndonjë vepër tjetër penale, të raportuar në Stacion Policor në Viti.

### **3. Mbrojtja e të akuzuarit A.I.**

I akuzuari A.I., në mbrojtjen e tij të dhënë dhënë në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 05.11.2024, nuk e pranoi se kishte ndezur zjarr për të eliminuar disa mbeturina me datën 21.02.2019, rreth orës 16:30, në fshatin G. Komuna Viti, pasi që këtë ditë e ka pasur nënën e sëmure dhe ka qenë duke e trajtuar në spitalin e Gjilanit. E njuh E.K.n, janë fqinjë dhe i njëjti ka shtëpi në fshatin Gjylekar, por jeton në Prishtinë. Në shtëpinë e E. edhe në vitin 2019 edhe sot ka të vendosur kamera të sigurisë dhe se me të gjithmonë kanë pasur raporte të mira. Theksoj se gjatë dhënies së deklaratës në Stacionin Policor në Viti, me datën 14.03.2019, ka deklaruar se ka ndezur një zjarr para 2 muajve nga ndodhja e rastit, por kjo nuk është shënuar në deklaratë dhe se kur ka nënshkruar deklaratën nuk i kanë thënë që ta lexoj. Në vitin 2019 ka theksuar se nuk ka ndezë ndonjë zjarr. Me rastin e ballafaqimit me deklaratën e dhënë në Stacionin Policor në Viti, ku i njëjti kishte deklaruar ‘‘data nuk i kujtohet, mirëpo e di se ka qenë paradite, ka qenë ditë e mirë duke kaluar kanalin afër arës sime e kam ndezur zjarrin, disa mbeturina në kanal dhe e kam ndezur një cigare’’. I akuzuari deklaroi se nuk është e vërtetë që kishte deklaruar kështu siq ishte shënuar, pasi që gjatë muajit shkurt të vitit 2019, nuk kishte ndezur zjarrin, ndërsa nënshkrimi në këtë deklaratë është i tij. Nuk ka raporte mjekësore lidhur me mjekimin e nënës së tij gjatë vitit 2019 dhe se me asnjë person deri më tani nuk ka pasur asnjë të keqe. Asnjëherë nuk kishte ndezur mbeturina në kanalin në fshatin G., ndërsa prona tij ishte në largësi rreth 200 metra, nga kanali ku ishte ndezur zjarri dhe prona tij nuk kufizohet me pronën e Q.H.t dhe as me pronën e E.K.t.

### **4. Vlerësimi i provave materiale:**

-Nga raporti fillestar i incidentit me numër të rastit 2019-CG-067, i datës 21.02.2019, paraqitur nga Njësia e Hetimeve të Stacionit Policor në Viti, gjykata vërtetoi faktin se me datë 21.02.2019 në ora 16:30, në Stacionin Policor në Viti, është raportuar një rast i shkaktimit të rrezikut të përgjithshëm në fshatin G., Komuna e Vitisë ku ankues ishte E.K. dhe si datë e incidentit është data 21.02.2019.

-Nga deklarata e të dëmtuarit E.K. e dhënë me datën 21.02.2019, në Stacionin Policor në Viti, gjykata vërtetoi faktin se me datën 20.02.2019, në fshatin Gjylekar, Komuna e Vitisë, ku i dëmtuari ka të mbjella 330 fidanë të llojit dardhë i janë dëmtuar nga një zjarr që e kishte përfshirë atë pjesë. Informatën për shkaktimin e zjarrit e kishte marrë nga familjarët e tij që jetojnë në fshatin G., pasi që i dëmtuari jetonte në Prishtinë. Zjarrfikësit kishin mbri në vendin e ngjarjes, po zjarri kishte përfunduar. Kishin informata disa persona që jetonin aty afër, mirëpo nuk i kishin dhënë ndonjë informatë se kush mund të jetë personi që kishte shkaktuar zjarrin dhe i dëmtuari nuk kishte dyshim në ndonjë person.

-Nga Deklarata e të akuzuarit A.I.e dhënë me datën 14.03.2019, e dhënë në Stacionin Policor në Viti, gjykata vërtetoi faktin se i akuzuari në datë të papërcaktuar (pasi që nuk i kujtohet data), ishte ditë e mirë, kishte ndezur disa mbeturina në kanalin, afër pronës së tij dhe e kishte pirë një cigare, ku ishte duke i lavëruar pronat e tij. Një ditë tjetër e kishte kuptuar se i ishin dëmtuar nga zjarri pemët e E., por nuk i’a kishte marr mendja se nga zjarri që kishte ndezur A. rreth orës 10:00, i cili ishte i vogël ta kishte përfshirë pronën e E., e cila ishte dëmtuar nga zjarri rreth orës 16:30.

-Nga Raport zjarri me numër Pr. 14/2019, e datës 23.02.2019, e lëshuar nga Ministria e Punëve të Brendshme, Zyra e Preventives ndaj zjarrit-Viti, gjykata vërtetoi faktin se me datën 20.02.2019, rreth orës

17:45, shërbimi i zjarrfikëseve ishte njoftuar se në fshatin G. Komuna Viti, kishte zjarr fushor dhe se kur kishin arrit zjarrfikësit, zjarri ishte fikur dhe nuk kishte pasur nevojë për intervenim. Me datë 23.02.2019, ditë e shtunë, ora 9:20-10:05 me kërkesë të policisë zjarrfikësit kishin dal në vendngjarje dhe kishin konstatuar se kishte zjarr fushor. Sipas këtij raporti zjarri kishte rënë në pronën e Q.H.t dhe përmes barit të thatë kishte mbërritur edhe në pemishten e tani të dëmtuarit E.K., afërsisht 20 ari sipërfaqe të mbjelluara me pemë. Nga kqyrja e vendit të ngjarjes nuk ishte vërejtë se ishin shkaktuar dëme metariale në pemishten e E.K.t, përpos që bari i thatë në mënyrë sipërfaqësore ishte djegur nga zjarri pjesërisht në pemishte. Zjarri ishte përhap nga djegia e mbeturinave aty afër dhe zjarri ishte përhap nën ndikimin e erës.

-Nga fotografi nga vendi i ngjarjes, e datës 23.02.2019 shifet një pronë e rrethuar me tel dhe me shtylla betoni, ka pasur zjarr fushor në stërnishte dhe bari i thatë i djegur ka depërtuar edhe në pemishten e tani të dëmtuarit E.K..

### **5.Konstatimet e gjykatës**

Në seancat e shqyrtimit gjyqësor në këtë çështje penale gjykata konform nenit 7 të KPPRK-së, saktësisht dhe në mënyrë të plotë vërtetoi faktet që janë të rëndësishme për marrjen e vendimit të ligjshëm, me vëmendje dhe përkushtim maksimal dhe me përkujdesje të njëjtë vërtetoi faktet kundër të akuzuarit si dhe ato në favor të tij, duke i mundësuar të akuzuarit shfrytëzimin e të gjitha fakteve dhe provave që janë në favor të mbrojtjes dhe me ndërgjegje vlerësoi çdo provë një nga një dhe në lidhje me provat tjera dhe në bazë të vlerësimit të tillë ka nxjerr përfundimin lidhur me faktet konkrete të vërtetuara, me ç'rast pas analizimit dhe vlerësimit të provave të cilat janë administruar në seancat e shqyrtimit gjyqësor, ka ardhur në përfundim se në këtë çështje penalo juridike nuk është vërtetuar përtej dyshimit të bazuar mirë se i akuzuari A.I.e ka kryer veprën penale shkaktim i rrezikut të përgjithshëm nga neni 365 paragrafi 6, lidhur me paragrafin 1 të Kodit Penal të Kosovës.

Gjykata deri tek një konstatim i tillë erdhi duke nxjerr përfundimet mbi faktet kontestuese dhe jo kontestuese në këtë çështje penalo juridike, ashtu që gjykata gjeti se nuk ishte kontestuese se në fshatin G. Komuna Viti ishte ndezur zjarr në kanalën e mbeturinave, për shkak të erës ky zjarr ishte shpërndarë në pronën e E.K.t dhe kishte dëmtuar fidanet e llojit dardhë, mirëpo kontestuese ishte se me veprimet e të akuzuarit a plotësohen elementet e veprës penale shkaktim i rrezikut të përgjithshëm nga neni 365 parag. 6, lidhur me parag.1 të KPRK-së, data dhe koha e saktë shkaktimit të zjarrit kur dyshohet se është kryer vepra penale, si dhe a ishte A.I.që me datë 21.02.2019, ora 16:30 kishte shkaktuar zjarrin në fshatin G. Komuna Viti.

Për gjykatën ishte relevante pjesa e deklaratës së të dëmtuarit, në cilësi të dëshmitarit E.K., të cilës i'a fali besimin, ku deklaroi se "asnjë person nuk i kishte thënë se A. e ka ndezur zjarrin", kjo pjesë e deklaratës gjen mbështetje në deklaratën e tij të dhënë në Stacion Policor në Viti, me datë 21.02.2019, ku kishte deklaruar "kishin informata disa persona që jetonin aty afër, mirëpo nuk i kishin dhënë ndonjë informatë se kush mund të jetë personi që kishte shkaktuar zjarrin dhe i dëmtuari nuk kishte dyshim në ndonjë person, si dhe në deklaratën e dëshmitarit Mehmet Mehmeti, ku deklaroi se: nuk kishte njohuri se kush e kishte përmend A.I.n si kryerës të kësaj vepre penale.

Gjykata nuk i'a fali besimin pjesës së dëshmisë së të dëmtuarit-dëshmitarit E.K. të dhënë në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 03.10.2024, ku deklaroi: një zyrtari policor të cilit nuk ja ka ditur emrin, me mbiemër Halabaku, i kishte thënë ti marrin inçizimet e kamerave, deklaratë e cila është në kundërshtim me deklaratën e vet të dëmtuarit, pasi që i dëmtuari në deklaratën e tij të dhënë në procedurë paraprake nuk kishte përmendur kamerat e sigurisë që kishin içizuar ngjarjen, si dhe është në kundërshtim me deklaratën e dëshmitarit M.D. e cili deklaroi: 'kishte pyetur E.n për këto kamera, pasi që kanë pasur qëllim që të verifikojnë, mirëpo i dëmtuari i kishte thënë kamerat nuk i kishin regjistruar pamjet për shkak të hardiskut me memorie të vogël, pasi që kamerat i regjistrojnë ngjarjet e ndodhura vetëm 2-3 ditë dhe se A.n, ditën kritike përmes kamerave të sigurisë e kishte parë duke ndezur zjarrin, ndërsa person tjetër nuk ka përmendur. Rasti në Stacionin Policor në Viti nga i dëmtuari është raportuar një ditë më vonë.

Deklarata e të dëmtuarit E.K., ku deklaroi se: në atë kohë ishte duke jetuar në Prishtinë, ku edhe kamerat i vëzhgonte nga atje dhe ditën kritike, pasdite ka dalur në vendin e ngjarjes dhe aty ka takuar zjarrfikësit duke fikur zjarrin, është në kundërshtim me Raportin e zjarrit Pr. 14/2019, e datës 23.02.2019, e lëshuar

nga Ministria e Punëve të Brendshme, Zyra e Preventives ndaj zjarrit-Viti, ku është konstatuar se “ zjarri ishte fikur vet”.

Pjesës tjetër e deklaratës së të dëmtuarit gjykata nuk i'a fali besimin, ku deklaroi se: “përmes kamerave kishte parë një kerr (rimorkio), ku kishte të vendosur pleh, e cila ishte e vendosur në arën e babait të A.I.t dhe në bazë të kamerave, kishte parë dy persona të cilët nuk ka mundur t'i identifikoj, të cilët ishin duke e zbrazur plehun nga rimorkio në tokën e tyre. Theksoj se nuk ka e ka parë momentin kur është ndezur zjarri, por e ka parë momentin kur zjarri ka përfshirë sernishten në arën e Qahili Hajdarit dhe se zjarri ka qenë në arën e Q.H.t, ndërsa kur e ka parë që zjarri është afruar te prona e tij (tek dardhat), e ka thirrë policinë dhe zjarrfikësit. Ishte duke jetuar në Prishtinë, ku edhe kamerat i vëzhgonte nga atje dhe ditën kritike, pasdite ka dalur në vendin e ngjarjes dhe aty ka takuar zjarrfikësit duke fikur zjarrin”. Në një pjesë të deklaratës deklaroi se informatën rreth zjarrit e kishte marrë nga një familjar i A.I.t, emrin e të cilit fillimisht theksoj se nuk dëshiron ta tregoj, ndërsa tutje deklaroi se këtë informatë e ka marr nga djali i vëllait të tij i cili quhet G.K., pastaj ka hy dhe i ka shikuar kamerat, e cila deklaratë është në kundërshtim me deklaratën e të dëmtuarit të dhënë në Stacion Policor në Viti, me datë 21.02.2019, ku kishte deklaruar “se me datën 20.02.2019, në fshatin G., Komuna e Vitisë, ku kishte të mbjellura 330 fidanë të llojit dardhë i janë dëmtuar nga një zjarr që e kishte përfshirë atë pjesë. Informatën për shkaktimin e zjarrit e kishte marrë nga familjarët e tij që jetojnë në fshatin G., pasiqë jeton në Prishtinë. Zjarrfikësit kishin mbri në vendin e ngjarjes, po zjarri kishte përfunduar.

Deklarata e dëshmitarit M.D. të dhënë në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 03.10.2024, nuk ishte relevante në këtë çështje penale, pasi që i njëjti ishte zyrtar policor, kishte kryer detyra e tij zyrtare, kishte dal në vendin e ngjarjes, kishte vërejtur se ishte një sernishte e djegur ndërsa nuk kishte njohuri se kush e ka përmendur A.I.n, si kryes i kësaj veprë penale.

Një pjesë e deklaratës së dëshmitarit M.D. të dhënë në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 05.11.2024, nuk ishte relevante në këtë çështje penale, pasi që i njëjti ishte hartues i kallëzimit penale, kishte kryer detyra e tij zyrtare, tre ose katër ditë më vonë kishte dal në vendin e ngjarjes. Për gjykatën ishte e rëndësishme deklarata e dëshmitarit që e njoftoj gjykatën se një ditë më vonë rasti ishte raportur nga E.K. në Stacion Policor në Viti. Po ashtu me shkaktimin e zjarrit nuk kishte rrezik të madh për njerëzit, pasi që në vendin ku është shkaktuar ka shtëpi rreth 300 m largësi.

Gjykata nuk i'a fali besimin pjesës së dëshmisë së dëshmitarit M.D. të dhënë në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 05.11.2024, ku deklaroi:”ka qenë një dëshmitar anonim, të cilin e kemi takuar kur kemi dal në teren në fshatin G. Komuna Viti, i cili në mënyrë verbale na ka njoftuar se e ka parë A.I.n, duke i'a treguar edhe datën, mirëpo nuk ishte shënuar askund ky informacion, pasi që dëshmitari ka pasur qëllim t'i ik konfliktit me A.n, pasi që ky veprim është në kundërshtim me dispozitat e Kodit të Procedurës Penale.

Deklaratës së të akuzuarit A.I., të dhënë në Stacion Policor në Viti me datë 14.03.2019, gjykata nuk i'a fali besimin pasi që shihet se i akuzuari rreth një muaj më vonë është intervistuar. Ka deklaruar se data nuk i kujtohet, ishte ditë e mirë, kishte ndezur disa mbeturina në kanal, afër pronës së tij dhe e kishte pirë një cigare, ku ishte duke i lavëruar pronat e tij. Një ditë tjetër e kishte kuptuar se i ishin dëmtuar nga zjarri pemët e E., por nuk i'a kishte marr mendja se nga zjarri që kishte ndezur A. rreth orës 10:00, i cili ishte i vogël ta kishte përfshirë pronën e E., e cila ishte dëmtuar nga zjarri rreth orës 16:30, për arsye se i akuzuari është pyetur për shkaktimin e zjarrit për datën 21.02.2019, ndërsa sipas deklaratës së të dëmtuarit të dhënë në Stacion Policor në Viti me datë 21.02.2019, shihet se zjarri është shkaktuar me datë 20.02.2019. Si dhe në ansjë pjesë të kësaj deklaratë nuk shënon se: “ procesverbali i është lëxuar të akuzuarit para dhënie së nënshkrimit të tij”.

Gjykata i'a fali besimin dëshmisë së të akuzuarit A.I., i cili në mbrojtjen e tij të dhënë në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 05.11.2024, ka deklaruar se: ”nuk është e vërtetë që të ketë ndezur zjarr për të eliminuar disa mbeturina me datën 21.02.2019, rreth orës 16:30, në fshatin G., pasiqë në këtë çështje penale nuk është vërtetuar data dhe koha e saktë e kryerjes së veprës penale. Mbrojtja e të akuzuarit gjen

mbështetje në deklaratën e të dëmtuarit E.K. të dhënë në Stacion Policor në Viti, ku si datë të kryerjes së veprës penale ka përmendur datën 20.02.2019 rreth orës 17:00.

Gjykata, gjatë vlerësimit të të gjitha provave materiale të ofruara nga Prokuroria, nuk ka mundur të nxjerrë elemente të cilat qojnë në fajësinë e të akuzuarit lidhur me veprën për të cilën akuzohet. Këtë përfundim gjykata e bazoi kryesisht në deklaratën e dëshmitareve M.D.dhe M.D., deklaratën e të dëmtuarit në cilësinë e dëshmitarit E.K., si dhe në mbrojtjen e të akuzuarit A.I.t dhe provave tjera të shqyrtuara materiale dhe nuk është vërtetuar se i akuzuari A.I.me datën 21.02.2019, rreth orës 16:30, në fshatin G., Komuna e Vitisë, ka shkaktuar rrezik të përgjithshëm për jetën e njerëzve dhe pasurinë e tyre, në atë mënyrë që i akuzuari duke shkuar tek arat e veta për të lëvruar dhe gjatë rrugëtimit deri tek arat e veta, ndalet tek kanali rreth rrugës dhe me qëllim të pastrimit të kanalit nga mbeturinat, të njëjtat mbeturina i ndezë dhe më pastaj nuk kujdeset për zjarrin që ta fik, ndërsa zjarri pastaj kalon dhe përfshinë pronën djerrinë të pronarit Q.H., pastaj kalon dhe përfshinë pronën e E. Hajdari, duke djegur dhe asgjësuar barin e thatë dhe 20 fidanë të mbjella, ndërsa më vonë për ta lokalizuar zjarrin kanë intervenuar njësia e zjarrfikësve nga Vitia, në këtë mënyrë i akuzuari me veprimet e veta nga pakujdesia ka shkaktuar rrezik të përgjithshëm për jetën e njerëzve dhe pasurinë e tyre dhe njëkohësisht si pasojë e zjarrit të dëmtuarit të sipër cekur i është shkaktuar edhe dëm material në vlerë prej rreth 500.00 (pesëqind) €.

Gjykata duke pasur në konsideratë nenin 7 paragrafi 1 dhe 2 të KPP-së, ku përcaktohet se gjykata, prokurori i shtetit dhe policia janë të detyruar që saktësisht dhe tërësisht t'i vërtetojnë faktet të cilat janë të rëndësishme për marrjen e vendimeve të ligjshme dhe me pakujdesje të vërtetojnë faktet kundër të akuzuarit dhe në favor të tij dhe bazuar në nenin 360 paragrafi 1 dhe 2 të KPP-së, ku përcaktohet se gjykata e bazon aktgjykimin vetëm në faktet dhe në provat e proceduara në shqyrtimin gjyqësor dhe detyrohet të vlerësoj çdo provë një nga një dhe në lidhje me provat tjera dhe në bazë të vlerësimit të nxirret përfundim nëse fakti konkret është provuar. Për të përcaktuar fajësinë dhe për ta shpallur fajtor të akuzuarin duhet të ketë prova bindëse dhe të pa kontestueshme, andaj gjykata pasi ka bërë administrimin e provave si atyre personale dhe provave materiale të administruara në shqyrtimin gjyqësor, janë prova të cilat nuk kanë vërtetuar ndonjë fakt relevant dhe në mungesë të provave për të vërtetuar të kundërtën, gjykata ka marrë aktgjykim lirues, pasi nuk është provuar se i akuzuari e ka kryer veprën penale me të cilin është akuzuar.

#### **6. Vendimi për lirimin e të akuzuarit nga akuza**

Gjykata ka ardhur në përfundim të kësaj çështje penale juridike nuk ka prova të mjaftueshme, gjegjësisht të besueshme dhe të sigurta se i akuzuari ka kryer veprën penale shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm nga neni 365 paragrafi 6, lidhur me paragrafin 1 të Kodit Penal të Kosovës, ku janë përcaktuar mëdyshjet lidhur me ekzistimin e fakteve të rëndësishme për çështjen konkrete interpretohen në favor të akuzuarit, andaj provat e siguruar nga prokuroria nuk janë të mjaftueshme, gjegjësisht të besueshme dhe të sigurta për të vërtetuar veprimet inkriminuese, se i akuzuari i lartcekur ta ketë kryer veprën penale për të cilën akuzohet dhe në mungesë të provave tjera bindëse vendosi me aktgjykim lirues në kuptim të nenit 363 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të KPPRK-së.

#### **7. Vendimi lidhur me kërkesën pasurore-juridike**

Gjykata në bazë të nenit 462 paragrafi 3 të KPP-së, të dëmtuarin E.K., për realizimin e kërkesës pasurore juridike e ka udhëzuar në kontest të rregullt juridiko civil.

#### **8. Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale**

Vendimi për shpenzimet e procedurës penale është marrë duke u bazuar në nenin 453 paragrafi 1 të KPPRK-së.

Andaj, duke u bazuar në të lartcekurat dhe në bazë të nenit 363 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të KPP-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**Gjykata Themelore në Gjiilan - dega Viti  
Departamenti i përgjithshëm  
P.nr. 171/2019, me datë 15.11.2024**

**Gjyqtarja e vetme gjyquese,  
Blerina Jakupi Ramadani**

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej tridhjetë (30) ditëve nga dita e pranimi të të njëjtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme i paraqitet kësaj Gjykate Themelore.